



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

01-060-01-27753-25

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg.

Data / Datum / Date

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC

16.09.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.26.08.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiçi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Besnik Salihu, zyrtar për buxhet dhe financa

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiçi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2025
4. Shqyrtimi i kërkesës nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve
5. Plani i veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024
6. Shqyrtimi i kërkesës nga Zyra e Personelit për Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës nga Zyra për Barazi Gjinore për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2025.

Enver Gashi – Raporti i Kryetarit si raport është i rëndomtë, është me kohë dhe nuk votohet. Ne jemi për atë që të shkoj në Kuvend dhe atje mund ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Ne jemi shumë dakord që ky raport të shqyrtohet në seancën e ardhshme ndërsa, nëse veç kemi ndonjë pyetje ose sugjerim e bisedojmë atje.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit Komunal për periudhën Janar-Qershor 2025.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve.

Enver Gashi – Ne si grup jemi dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend për miratim.

Sami Ahmeti – Ne në fakt jemi për që kjo temë të diskutohet atje, ndërsa qysh tani kemi vërejtjet tona mirëpo do ti themi në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Drejtoria për ekonomi, financa dhe zhvillim për transfer të mjeteve.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Planin e veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024.

Enver Gashi – Në parim jemi që edhe kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe i sugjerojmë Ekzekutivit, që aty ku ka vërejtje të përmirësohen.

Sami Ahmeti - Është një rregullë që pas Raportit të auditimit duhet të bëhet edhe një Plan dhe jo vetëm për këtë pikë, por për të gjitha pikat vijuese ne jemi dakord që këto të diskutohen. E tha edhe parafolësi, ne kishim dashtë që të jenë personat kompetentë në seancë në mënyrë që nëse, kemi diçka me thënë kryesisht për rekomandimet e përsëritura që të jenë në dispozicion të pyetjeve tona. Përndryshe, ne jemi dakord që kjo pikë të shkoj në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Planin e veprimeve për Zbatimin e Rekomandimeve për Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga Zyra e Personelit për Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi dakord që Rregullorja të shkon për shqyrtim dhe aprovim në Kuvend, pasi që ka qenë në debat publik dhe janë kryer anët ligjore.

Sami Ahmeti – Për ata që e dijnë dhe e kuptojnë kjo është njëra prej Rregulloreve më të rëndësishme për shërbyesit civil, shërbyesit publik që i kemi në Komunë dhe krejtë organizatat brenda përbrenda Komunës. Një vërejtje të vogël e kam kryesuese se ne kur e kemi dhënë pëlqimin për me dalë në debat publik, unë të paktën kam thënë se kam dëshirë të jem i ftuar kur ka debat publik. Mirëpo, nuk kam parë se kemi ndonjë ftesë sepse edhe në Ministri ku e kam mbulesë pikërisht merrem me sistematizimin e vendeve të punës në krejtë administratën shtetërore, kështu që ndodhë që do të kisha dhënë ndonjë kontribut, por kjo nuk do të thotë se nuk mundemi deri të premtën me i shfletue këo dokumente dhe me pa se çka kemi mundësi me dhënë kontribut. Këta shërbyes që ne i kemi për mendimin tim janë shumë të rëndësishëm pa marrë parasysh kush ka pushtet ose kush e merrë pushtetin edhe duhet të trajtohen njësoj. Kjo nuk do të thotë se unë nuk do të provoj me dhënë kontributin tim në seancë. Ne jemi shumë dakord që kjo të shkoj në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesja - Unë si kryesuese dhe ne si sekretari e Kuvendit nuk kemi bë ftesë për debat publik sepse njoftimi ka qenë sipas ligjit 15 ditë para se të mbahet debati publik, që juve iu ka ikë, por njoftimi sigurisht se ka qenë në faqen zyrtare të Komunës.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Zyra e Personelit për Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Komunën e Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja - Paraqiti kërkesën nga Zyra për Barazi Gjinore për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në Kuvend dhe në parim jemi që ky Plan të jepet në debat publik. Siç tha parafolësi për debatet publike është mirë që sa më shumë anëtarët e Kuvendit me qenë aty që ndoshta, është një kontribut më i hershëm në debatet publike sepse në fund prapë vjen në Kuvend dhe ne e kemi të drejtën me i dhënë vërejtjet, sugjerimet tona dhe ka mundësi edhe në Kuvend të aprovohen.

Sami Ahmeti – Po jemi dakord që ky dokument të shkoj në seancë dhe rrjedhimisht të dalë në debat publik. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga Njësia për Mbrojtje nga Diskriminimi për dhënien në debat publik të Planit për të drejtat e fëmijëve 2026-2029.

Pika 8 e rendit të ditës


Kryesuesja – Ju njoftoj se nuk na ka ardhë asnjë kërkesë për shqyrtim.

Pika 9 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – Si një nga temat që mund të diskutohet duke pasë parasysh që në javën e ardhshme fillon procesi arsimor unë ndoshta çdo herë në gusht e bëjë këtë kërkesë që Drejtoria e Arsimit të na informoj se qysh jemi me parapërgatitjet dhe përgatitjet për procesin arsimor.

Mbledhja përfundoi në ora 11:18'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

